

Raporti Financiar dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Më dhe për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2015

Përmbajtja

| | Faqe |
|---|------|
| Raporti i Auditorit të Pavarur | 1 |
| Pasqyra e Burimit dhe Përdorimit të Fondeve | 3 |
| Shënimet e Pasqyrës së Burimeve dhe Përdorimit të Fondeve | 4 |
| Shtojca 1 Mjetet Fikse | 11 |

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rr. Rexhep Mala 18
10 000 Prishtina
Kosovo

T +381 38 247 771
T +381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grant-thornton.com.mk

Për Menaxhmentin e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Ne kemi audituar raportin financiar të Asociacionit të Komunave të Kosovës (“Asociacioni” ose “AKK”), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Burimeve dhe Përdorimit të Fondeve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2015 dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informatave tjera sqaruese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për raportin financiar

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të raportit financiar në përputhje me bazën kontabël të pranimit dhe pagesave në para të gatshme dhe për kontrollet të tilla që menaxhmenti përcakton se janë të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban gabime materiale, qoftë nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi raportin financiar bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse raporti financiar është pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi për shumat dhe shpalosjet në raportin financiar. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të raportit financiar si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshëm relevant në përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë e raportit financiar të entitetit në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Auditimi përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të raportit financiar.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, raporti shoqërues financiar paraqet në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të hyrat e mbledhura dhe shpenzimet e paguara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2015 në përputhje me parimin kontabël të pranimeve dhe pagesave në para të gatshme.


Grant Thornton LLC
Grant Thornton LLC

Prishtinë, Kosovë
14 Mars 2016

Pasqyra e Burimit dhe Përdorimit të Fondeve

| | Shënime | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 (in EUR) | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 (in EUR) |
|---|---------|--|--|
| BURIMET E FONDEVE | | | |
| Fondet e donatorëve | 3 | 318,394 | 363,467 |
| Pjesëmarrja e komunave në të hyra | 4 | 117,712 | 136,565 |
| <u>Të hyra të tjera</u> | | 634 | 3,410 |
| TOTALI I FONDEVE NE DISPOZICION | | 436,738 | 503,442 |
| PËRDORIMI I FONDEVE | | | |
| Shpenzimet e personelit | 5 | 160,301 | 148,357 |
| Lobimi / Avokimi | 6 | 121,037 | 74,421 |
| Pajisje dhe furnizime të zyrës | 7 | 12,525 | 10,384 |
| Shërbime të zyrës | 8 | 26,888 | 40,102 |
| Shpenzimet e udhëtimit | 9 | 8,362 | 12,688 |
| Komunikimet dhe publikimet | 10 | 30,514 | 36,852 |
| Ngritja e kapaciteteve | 11 | 43,983 | 84,143 |
| Shpenzimet e tjera | 12 | 15,934 | 12,559 |
| Totali i Shpenzimeve | | 419,544 | 419,506 |
| Suficiti i fondeve të pranuar mbi shpenzimet | | 17,196 | 83,936 |
| Fondet e kthyer tek donatorët | 3 | (2,583) | - |
| Suficit i Fondeve | | 14,613 | 83,936 |
| Gjendja fillestare e parasë së gatshme dhe në bankë | | 127,989 | 44,053 |
| Paraja e gatshme dhe në bankë në fund të periudhës | 13 | 142,602 | 127,989 |

Ky raport financiar është aprovuar nga Menaxhmenti më 27 Shkurt 2016 dhe nënshkruar në emër të tij nga:


Sazan Ibrahim
Drejtor Ekzekutiv




Mexhit Shaqiri
Menaxher Financiar

Shënimet e Pasqyrës së Burimeve dhe Përdorimit të Fondeve

1 Hyrje dhe politikat operative

Asociacioni i Komunave të Kosovës ("Asociacioni ose AKK") është regjistruar në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut si organizatë jo qeveritare më 17 Dhjetor 2002 dhe operon në Prishtinë, me numër të regjistrimit 5101800-1.

Misioni

Misioni i Asociacionit është që të krijojë qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme dhe demokratike përmes performancës së kualitetit të lartë në shërbimin e nevojave të qytetarëve të saj.

Qëllimi

Asociacioni i Komunave të Kosovës është interes i përbashkët i pjesëtarëve për kushtet dhe rrethanat në të cilat vepron.

Asociacioni ka karakter profesional e assesi politik, me obligim të demokratizimit të mëtutjeshëm të shoqërisë kosovare.

Asociacioni do të jetë organizëm i fortë midis pushtetit lokal dhe atij qendror, duke i mbrojtur pareshtur kompetencat e komunave nga tendencat centraliste si dhe duke i avancuar ato në harmoni me aktet në fuqi.

Asociacioni, përveç demokratizimit të shoqërisë (përmes demokratizimit të institucioneve), do të punojë në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, forcimin e bashkëpunimit mes komunave si dhe në integrimin e komuniteteve në shoqërinë kosovare.

Qëllim kryesor i këtij Asociacioni do të jetë qeverisja e mirë dhe e suksesshme në nivelin lokal, duke i dalë zot përgjegjësisë së dhënë në të gjitha fushat shoqërore që i përkasin.

Asociacioni do të ketë synim harmonizimin e niveleve të ndryshme të qeverisjes si dhe flakjen e paralelizmave të panevojshme, pavarësisht nga adresohen.

Asociacioni do të bashkëpunojë dhe aderojë me asociacionet simotra evropiane -- ndërkombëtare si dhe do të bazohet në Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale (neni 4, artikulli 6) ku thuhet: bashkësive lokale duhet t'u kërkohet mendimi, brenda mundësive, në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme, gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për çështjet që u përkasin drejtpërsëdrejti, duhet respektuar.

1 Hyrje dhe politikat operative (vazhdim)

Objektivat

Përmirësimi i strukturave legjislativë të vetëqeverisjes dhe efikasiteti praktik i implementimit të tyre;

Nxitja e decentralizimit të pushtetit, përmes mbështetjes praktike dhe bashkëpunësimit mbi baza të barabarta, mes Autoriteteve qendrore dhe atyre lokale; Zgjerimi i mbështetjes publike për demokracinë lokale që përfshin qytetarët dhe komunitetin e biznesit dhe ngritja e besimit në vetorganizimin e tyre dhe gatishmërisë së tyre për të marrë pjesë në qeverisjen lokale;

Rritja e kompetencave, njohurive dhe kapaciteteve të Komunave për të siguruar kualitete të larta dhe efektive në shërbimet lokale;

Gjetja e burimeve alternative financiare për Komunitat;

Demonstrimi se Komunitat e Kosovës janë të barabarta dhe kanë partneritet konkurrues me Autoritetet lokale në Evropë dhe në mbarë Botën;

Mbështetja e zhvillimit të Asociacionit në përputhje me ndryshimet në qarqet e brendshme dhe të jashtme.

2 Politikat Kontabël

2.1 Baza e përgatitjes

Raporti financiar është përgatitur në përputhje me bazën kontabël të pranimit dhe pagesave në para të gatshme. Sipas parimit të pranimit dhe pagesave në para gatshme, të hyrat njihen kur pranohen e jo kur fitohen, dhe shpenzimet njihen kur paguhen dhe jo kur ndodhin. Kostot që lidhen me blerjen e mjeteve fikse nuk janë të kapitalizuara.

Të gjitha të dhënat në raportin financiar janë të shprehura në Euro (valuta ligjore në territorin e Kosovës). Sipas nevojës, shifrat krahasuese janë ri-klasifikuar në mënyrë që të jenë në përputhje me prezantimin e vitit aktual.

3 Fondet e donatorëve

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 (in Euro) | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 (in Euro) |
|---------------------------------------|---|---|
| SDC | 210,000 | 338,000 |
| GIZ | 96,400 | 6,000 |
| NALAS | 7,409 | 10,670 |
| COUNCIL OF EUROPE (CoE) 2013 | 4,585 | 5,686 |
| AMICI DEI BAMBINI | - | 2,192 |
| WHO | - | 919 |
| Totali i Fondeve të Donatorëve | 318,394 | 363,467 |

Më 23 dhjetor 2013, AKM ka nënshkruar një kontratë vazhduese me SDC për një shumë totale prej EUR 200.000 për periudhën prej 01 Janar 2014 deri më 30 Qershor 2014, dhe më 01 Korrik 2014 AKK ka nënshkruar kontratën e re me SDC që ka zëvendësuar kontratën me 23 Dhjetor 2013. Totali i shumës së kësaj kontrate është EUR 900.000, kurse periudha e kontratës është nga 01 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor 2017. Gjatë vitit 2015, në lidhje me këtë kontratë, Asociacioni ka pranuar një shumë prej EUR 210,000.

Asociacioni ka nënshkruar një kontratë për donacion me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) me 03 Mars 2015 në vlerë prej Eur 47,000 për të mbështetur projektin "Sustainable Municipal Services". Qëllimi i projektit është të synoj përdorimin sa më të mirë të praktikave/performancave të komunave të Kosovës duke i përhapur ato edhe në komunat tjera. Kohëzgjatja e këtij projekti është për periudhën nga 2 Mars 2015 deri më 30 Nëntor 2015. Gjatë vitit 2015, në lidhje me këtë kontratë, Asociacioni ka pranuar një shumë prej EUR 47,000. Përveq kësaj, Asociacioni ka nënshkruar një tjetër kontratë me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) me 30 Janar 2015 në shumë prej EUR 49,400 për të mbështetur me subvencione projektin "Energy Efficiency in Municipal Associations – EeMa". Qëllimi i projektit është të mbështesë Asociacionin e Komunave të Kosovës në ndërtimin e kapaciteteve të tyre, nëpërmjet kësaj, në mënyrë të tërthortë për të mbështetur komunat për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore në fushën e eficiencës së energjisë. Gjatë vitit 2015, në lidhje me këtë kontratë, Asociacioni ka pranuar shumën prej EUR 49,400.

3 Fondet e donatorëve (vazhdim)

Asociacioni ka nënshkruar një marrëveshje administrative me Council of Europe më 26 Maj 2015 për të mbështetur shpenzimet me organizimin e punetorisë në lidhje me etikën publike në Kosovë të mbajtur më 23 Shtator 2015. Gjatë vitit 2015, në lidhje me këtë kontratë, Asociacioni ka pranuar shumën prej EUR 4,585.

Asociacioni ka nënshkruar një kontratë për donacion me Network of Associations of Local Authorities of South-East Europe (NALAS) më 31 Dhjetor 2014 për të angazhuar një Asistent të Menaxhimit të Njohurive Kombëtare të NALAS për një shumë prej EUR 500 në muaj për periudhën nga 1 Janar 2015 deri 31 Dhjetor 2015. Qëllimi kryesor i projektit të promovuar nga granti është të ju mundësoj anëtareve të NALAS që të procesojnë në mënyrë efektive informacionet që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale dhe të sigurojnë të dhëna të nevojshme të qendra e njohurive NALAS, përmirsimin e qasjes në informacione të veqanta dhe përdorimin e njohurive të NALAS nga qeveria në SEE në mënyrë që të aplikojnë praktikat më të mira që dalin nga regjioni. Gjatë vitit 2015, në lidhje me këtë kontratë, Asociacioni ka pranuar shumën prej EUR 5,985. Më 1 Shtator 2014 Asociacioni ka nënshkruar kontratë tjetër donacioni për projektin Menaxhimi i aseteve për sektorin e ujit dhe sanitarisë për periudhën 1 Shtator 2014 deri 30 Shtator 2015, shtuar kohëzgjatjen deri më 30 Prill 2016. Gjatë vitit 2015 në lidhje me këtë kontratë Asociacioni ka pranuar shumën prej EUR 1,424.

Asociacioni ka nënshkruar kontratë për donacion me Organizatën Shëndetësore Botërore (WHO) më 3 mars 2013 për projektin “Forcimi i zbatimit të konceptit të Mjekësisë Familjare në Komunitet e Kosovës” për periudhën prej 18 mars 2013 deri 18 gusht 2013 për një shumë maksimale prej EUR 13,300. Gjatë vitit 2014, Asociacioni ka pranuar një shumë prej EUR 919 në lidhje me këtë kontratë.

Asociacioni ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Amici de Bambini më 9 janar 2014 për projektin “Mbështetja e qendrave sociale përmes Kolegjiumit të drejtorëve të komunave për shëndetin dhe pasurinë shoqërore.” Periudha e përgjithshme e projektit është 1 korrik 2014 deri 31 dhjetor 2014 për një shumë prej EUR 2,192 që është pranuar nga Asociacioni gjatë vitit 2014.

4 Pjesëmarrja e komunave në të hyra

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 (in Euro) | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 (in Euro) |
|---|---|---|
| PRISHTINE | 19,890 | 19,890 |
| PEJE | 9,645 | 9,645 |
| GJAKOVA | 9,456 | 9,456 |
| GJILAN | 9,018 | 9,018 |
| PRIZREN | 8,896 | 12,902 |
| PODUJEVE | 7,924 | 5,212 |
| LIPJAN | 5,761 | 5,760 |
| RAHOVEC | 5,621 | 4,216 |
| SKENDERAJ | 5,086 | - |
| DRENAS | 4,784 | 3,995 |
| VITI | 4,699 | 4,699 |
| KAÇANIK | 4,176 | 2,506 |
| ISTOG | 3,929 | 3,929 |
| DRAGASH | 3,400 | 1,700 |
| SHTIME | 2,732 | 2,732 |
| VUSHTRRI | 2,329 | 6,987 |
| OBILIQ | 2,155 | 2,155 |
| FERIZAJ | 2,000 | 10,861 |
| KAMENICE | 1,805 | 3,608 |
| GRAÇANICË | 1,068 | 1,068 |
| HANI I ELEZIT | 940 | 940 |
| NOVOBËRDË | 673 | 673 |
| JUNIK | 608 | 608 |
| MAMUSHE | 551 | 551 |
| RANILLUG | 387 | 387 |
| PARTESH | 179 | 179 |
| FUSHË KOSOVË | - | 5,435 |
| MITROVICE | - | 4,212 |
| SUHAREKË | - | 2,986 |
| MALISHEVE | - | 255 |
| Totali i Pjesëmarrjes së Komunave në të Hyra | 117,712 | 136,565 |

Sipas vendimit të Kuvendit të Shoqatës më datë 14 Mars 2014 dhe në përputhje me nenin 4, pikat 4.14.2 të Statutit të AKK, anëtarët e Asociacionit (komunat) janë të detyruar të paguajnë një tarifë mujore për anëtarësim, si i miratuar nga Kuvendi Asociacionit. Ky detyrim është disbursuar nga çdo komunë sipas formulës së re të propozuar për tarifën e anëtarësisë në AKK. Tarifa e anëtarësimit është vendosur të jetë 0.10 euro për kokë banori duke përdorur si kriter numrin e popullsisë në Komunat e Kosovës.

Për fund vitin më 31 dhjetor 2015, Asociacioni ka pranuar një shumë prej EUR 117,710 nga tarifën e anëtarësisë prej Komunave të Kosovës (Për fund vitin më Dhjetor 2014: EUR 136,565). Kjo shumë shërben si një buxhet operativ i Asociacionit, dhe është përdorur për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative të zyrës së Asociacionit.

5 Shpenzimet e Personelit

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 (in Euro) | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 (in Euro) |
|---|---|---|
| Stafi i rregullt | 101,484 | 108,313 |
| Konsulentët dhe ekspertët e jashtëm | 30,292 | 15,916 |
| Shpenzimet tjera të lidhura me stafin (tatimet dhe pensionet) | 28,525 | 24,128 |
| | 160,301 | 148,357 |

6 Lobimi / Avokimi

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 |
|---------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Takimet e kolegjiemeve | 36,541 | 28,900 |
| Shpërblimet për komunal fituese | 20,779 | - |
| Kuvendi i AKK-se | 17,580 | 9,958 |
| Takimet dhe konferencat Lokale | 16,904 | 9,762 |
| Takimet dhe konferencat ndërkombëtare | 15,628 | 12,678 |
| Vizitat studimore | 10,000 | 10,000 |
| Përfaqësimi | 3,605 | 3,123 |
| | 121,037 | 74,421 |

7 Pajisjet dhe furnizimet e zyrës

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 |
|---|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Pajisjet për zyrë (letra dhe materiale tjera) | 5,024 | 3,502 |
| Pajisje Tjera | 2,700 | 2,700 |
| Artikujt higjienike për zyrën | 1,935 | 1,500 |
| Pajisje të zyrës | 1,766 | 1,506 |
| Pajisje tjera | 1,100 | 1,176 |
| | 12,525 | 10,384 |

8 Shërbimet e zyrës

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 |
|-----------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Përkthimi | 9,410 | 23,288 |
| Qiraja e Zyrës | 7,800 | 7,500 |
| Shërbimet Postare | 3,520 | 4,085 |
| Energjia elektrike | 2,246 | 1,898 |
| Interneti | 1,532 | 1,523 |
| Equipment maintenance (servicing) | 1,405 | 1,005 |
| Uji | 615 | 443 |
| Mirëmbajtja e ndërtesës/Sigurimi | 360 | 360 |
| | 26,888 | 40,102 |

9 Shpenzimet e udhëtimit

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 |
|---------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Karburant për automjete | 4,476 | 5,082 |
| Transporti (Biletat, etj) | 3,245 | 6,560 |
| Viza (taksat/shpenzimet) | 539 | 910 |
| Sigurimi / shëndetit në udhëtim | 102 | 136 |
| | 8,362 | 12,688 |

10 Komunikimet dhe publikimet

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 |
|--|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Publikime të ndryshme (Deklarata Parimore etj.) | 20,680 | 12,982 |
| Buletini i AKK-se | 9,000 | 6,000 |
| Webfaqja e AKK / IT | 834 | 870 |
| Materiale trajnuese për anëtarët e rinj të Kuvendeve Komunale | - | 17,000 |
| | 30,514 | 36,852 |

11 Ngritja e kapaciteteve

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 |
|---|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Këshillimet nga jashtë | 17,800 | - |
| Strategjia e AKK-së 2016-2020 | 13,000 | - |
| Ngritja e kapaciteteve për Zyrtarët Komunal | 9,192 | 11,292 |
| Trajnimet e stafit | 3,991 | 5,000 |
| Sesionet e trajnimit për anëtarët e rinj të kuvendeve komunale | - | 58,600 |
| Zhvillimi i Strategjive të Kolegjiemeve të AKK-së | - | 9,251 |
| | 43,983 | 84,143 |

12 Shpenzimet tjera

| | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2015 | Për fund vitin më 31 Dhjetor 2014 |
|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------|
| Automjete për zyrë | 5,500 | - |
| Mirëmbajtje e automjeteve (servisim) | 4,210 | 5,726 |
| Shpenzimet për auditimin e pavarur | 2,950 | 4,425 |
| Shpenzime tjera | 2,345 | 1,479 |
| Provizioni i bankës | 561 | 453 |
| Karburant për gjenerator | 367 | 476 |
| | 15,934 | 12,559 |

13 Paraja e gatshme dhe në bankë

| | Më 31 Dhjetor 2015 | Më 31 Dhjetor 2014 |
|-----------------|--------------------|--------------------|
| Paraja në bankë | 142,117 | 127,636 |
| Paraja në Dorë | 485 | 353 |
| | 142,602 | 127,989 |

Shtojca 1 Mjetet Fikse

| Description | Date | Donor | Purchase Price |
|--|-------------|-------|----------------|
| Skaner i shpejtë për dokumente | Gusht-06 | EAR | 3,925 |
| Komputerë | Gusht-06 | EAR | 2,869 |
| Laptop | Gusht -06 | EAR | 1,518 |
| Projektor | Gusht -06 | EAR | 277 |
| Kopjues i CD-ve | Gusht -06 | EAR | 3,090 |
| UPS | Gusht -06 | EAR | 284 |
| Pajisje për Përkthim Simulant | Gusht -06 | EAR | 27,916 |
| Kamerë Digjitale | Gusht -06 | EAR | 325 |
| Ekran Portativ i Projektorit | Gusht -06 | EAR | 1,534 |
| Komputerë | Nentor-09 | GTZ | 3,786 |
| Laptop | Nentor -09 | GTZ | 966 |
| Projektor Toshiba | Nentor -09 | GTZ | 1,241 |
| Printer | Nentor -09 | GTZ | 509 |
| Automjet (Passat) | Korrik-08 | GTZ | 7,200 |
| Gjenerator për zyrë | Tetor-06 | AKM | 950 |
| Automjet (PASAT) | Gusht -09 | AKM | 19,500 |
| Komputerë | Shtator-09 | AKM | 1,830 |
| Laptop | Shtator -09 | AKM | 570 |
| Server i AKK-së | Tetor -09 | AKM | 1,300 |
| Fotokopje | Shtator -09 | AKM | 1,590 |
| Laptop DELL Inspiron N5110 | Dhjetor-11 | AKM | 729 |
| Canon ALL IN ONE | Dhjetor -11 | AKM | 266 |
| Laptop TOSHIBA Satellite | Tetor -11 | GIZ | 639 |
| PC Fujitsu | Janar-12 | AKM | 499 |
| Fotokopje | Qershor-12 | AKM | 1,864 |
| Air conditioner | Qershor -12 | AKM | 435 |
| Air conditioner | Qershor -12 | AKM | 244 |
| Aparat fotografik | Korrik-12 | AKM | 730 |
| Shneider (Rexel85) | Korrik-12 | AKM | 483 |
| TV Sony | Nentor -12 | AKM | 668 |
| Gjenerator i zyrës | Dhjetor -14 | AKM | 400 |
| Fujitsu Monitor / Fujitsu PC I5 Esprimo P420 | Gusht -14 | AKM | 693 |

| | | | |
|---|-------------|---------|---------------|
| Llaptop Fujitsu I5 Lifebook A544 | Tetor -14 | AKM | 515 |
| Llaptop Notebook Fujitsu LB A555 | Dhjetor -15 | AKM | 525 |
| Navigacion per veture (GARMIN GPS NUVI 55LM, EUROPE 2015 | Nentor -15 | AKM | 180 |
| Veture | Janar-15 | AKM/SDC | 5,500 |
| | | | 88,350 |

Sazan Ibrahim
Drejtor Ekzekutiv

Mexhit Shaqiri
Menaxher Financiar



Grant Thornton

www.grant-thornton.com.mk